



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 11860 Prot
Shkodër, më 19.07.2018

N. THE DOOR

THE DOOR

Nr. 2 Prot
Shkodër, më 19.07.2018

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Sot me datë ___/ ___/2018 lidhet kjo marrëveshje bashkëpunimi mes palëve:

Bashkia Shkodër me seli ligjore në rrugën “13 Dhjetori”, Shkodër, përfaqësuar nga zj. Voltana Ademi në cilësinë e titullarit të institucionit,

dhe

The Door, me seli në lagjen Rr. Bujar Beshanaku, Shkodër, përfaqësuar nga z. Kastriot Faci në cilësinë e drejtorit ekzekutiv të shoqatës.

Baza ligjore:

Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

Ligji nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar

VKB nr.1, datë 22.1.2016 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër, i ndryshuar,

Ligji Nr.93/2015, “Për Turizmin” i ndryshuar.

Neni 1

Qëllimi i marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje ka për qëllim:


- Të kontribuojë në promovimin e resurseve natyrore që ofron natyra e Shkodrës si dhe sportet natyrore për të nxitur dhe përfshirë sa më shumë të rinjtë e qytetarë në aktivitete ekoturistike.

Neni 1

Objektivi

Bashkëpunimin me qëllim organizimin e aktivitetit “**1-vit kënaqësi me Taraboshin**”. Ky eveniment do të organizohet në kuadër të 1-vjetorit të themelimit të klubit “Taraboshi”. Qëllimi i aktivitetit është promovimi i resurseve natyrore që ofron natyra e Shkodrës si dhe sportet natyrore

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al



që organizon klubi Taraboshi për të nxitur dhe përfshirë sa më shumë të rinjtë e qytetarë në aktivitete ekoturistike.

Përrjashtimin nga tarifa e përkohshme e Shoqatës The Door për aktivitetin e organizuar në partneritet me Bashkinë Shkodër për promovimin e territorit.

The Door është e detyruar të mirëmbaje ambjentet gjatë aktivitetit si dhe në fund të aktivitetit të lihet sheshi në rregull.

Neni 2

Afat i marrëveshjes

Kjo marrëveshje bashkëpunimi lidhet nga palët me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, me afat nga momenti i nënshkrimit të saj deri me datë 21.07.2018.

Neni 3

Forma e bashkëpunimit

Koordinimi dhe monitorimi i organizimit të aktivitetit të përbashkët "1-vit kënaqësi me Taraboshin.

Neni 4

Komunikimi

Çdo komunikim midis palëve do të bëhet me shkrim.

Neni 5

Njoftimet

Çdo njoftim, kërkesë apo çdo lloj komunikimi mes palëve do të bëhet sipas mënyrës së parashikuar në këtë marrëveshje bashkëpunimi, njoftimi i palëve do të bëhet me shkrim brenda 5 ditëve nga marrja dijeni e faktit dhe problemeve që mund të lindin gjatë ekzekutimit të marrëveshjes.


Neni 6

Zgjidhja e marrëveshjes

Asnjëra nga palët nuk ka të drejtë të zgjidhë këtë marrëveshje në mënyrë të njëanshme pa shkaqe të arsyeshme dhe para se të kenë njoftuar me shkrim njëra-tjetrën të paktën 5 ditë përpara.

Palët bien dakort që çdo mosmarrëveshje apo kontradite do të përpiqen t'i zgjidhin me mirëkuptim.

Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ose konfliktit, ato i drejtohen zgjidhjes së marrëveshjes dhe procedurave juridike në fuqi, sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.



A large, stylized handwritten signature in black ink, located at the bottom right of the page.


Neni 7

Dispozitat e fundit

Kjo marrëveshje bashkëpunimi do të quhet e vlefshme duke filluar nga data e nënshkrimit të saj nga palët.

Kjo marrëveshje u hartuar në tre kopje, nga të cilat njëjën e merr shoqata ndërsa dy Bashkia Shkodër.

**PËR
BASHKINË SHKODËR**

KRYETAR

Voltana Ademi

**PËR
THE DOOR**

DREJTOR EKZEKUTIV


Kastriot Faci

